



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:255718
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05389848

C. nr. 3640/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqësojnë avokatet B.K. dhe F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I.** APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.B. nga Prizreni, DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësit në emër të shujtave ditore për 95 ditë pune, (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022) ti paguaj shumën e përgjithshme prej 190.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 09.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II.** DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi N.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarve të tij, pranë kësaj gjykate, me datën 09.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave, vlera e kontestit 190.00 euro.

Të autorizuarit e paditësit në padi kanë theksuar se paditësit i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), nga 2 euro në ditë, për çdo ditë pune, për 95 ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë DKA-së, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësues ligjore të komunës, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Kanë theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarit të të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë e sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës në SHFMU “Besim Ndrecaj” në fshatin Lutogllavë, Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi i lëshuar me numër reference 96/2023, të datës 30.10.2023, nga drejtori i shkollës të SHFMU “Besim Ndrecaj” në fshatin Lutogllavë, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.B. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune-mësimdhënës pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ka punuar gjithsej 95 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë*

pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësin si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësin N.B. nga Prizreni, kërkesa është bërë e arritshme për 95 ditë pune, përkatësisht për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), apo shuma e përgjithshme prej 190.00 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsë në këtë gjykatë (09.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr.3640/2023, datë 28.02.2024

G j y q t a r i
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.